

SKEDË TEKNIKE

RÖFIX Renostar®

Rinovues dhe masë ngjitëse universale




Fushat e përdorimit

Rinovues mineral-dhe masë stukimi për zona universale përdorimi. Shpeshësia e aplikimit është e mundur nga 1 në 10 mm me një shtresë. Masë përforcuese për rinovimin e suvave në fasada me izolim termik, në kombinim me rretjen përforcuese RÖFIX P50. Suva niveluese për përmirësimin e suvave, bazamenteve të zakonshëm të ndërtimit. Masë shpatulluese ngjitëse e cila hapet me krëhër mbi bazamente betoni, për suva mbushëse me bazë gëlqere, me metodën e freskët mbi të freskët. Lëndë ndërtimi minerale sipas shtojcës A të katalogut për masat ekologjike për kërkesat në ndërtimin e shtëpive Mos i përdorni në bodrume dhe në nivelin 0. Nuk duhet të përdoret për ngjitjen e pllakave të termoizolimit. Si stuko riparuese gjatë rinovimit të fasadave të vjetra të termoizolimit (riparim i krisjeve). Për përpunimin e suvave të vjetra mbajtëse (edhe finot e lëngshme me bazë alkalike) dhe mbi bojra të vjetra mbajtëse si dhe mbi krisjet jo statike. Pas lidhjes së plotë të suvasë mbushëse me murin aplikoni sipër vetëm fino minerale, me difuzion të lartë ndaj avujve t 7 ujit si (RÖFIX - fino silikat/ silikoni si dhe SiSi RÖFIX).


Karakteristikat

- Përpunim i shkëlqyer
- I armatosur me fibra
- Ngjitje shumë e mirë
- Tkurrje e ulët, SR1

Përpunimi



Të dhëna teknike

Numri i artikullit	10189
EAN	9003304101894
Paketimi	
Sasi për njësi	25 kg/Nj.
Njësi për paletë	48 Nj./Pal
Madhësia e kokrrizave	0-0,5 mm
Konsumi	rreth. 1,5 kg/m ² /mm
Udhëzime për përdorimin	Të dhënat mbi konsumin janë orientuese, ato varen shumë nga karakteristikat e bazamentit dhe nga teknika e aplikimit. Kur zhvillohet punimi për herë të parë dhe në raste të aplikimit në sipërfaqe të mëdha këshillohet realizimi paraprakë në nje sipërfaqe prove.
Njësia e kërkesës për ujë	rreth. 7,5 L/Nj.
Reaksioni ndaj zjarrit	A2-s1, d0
Përshkueshmëria e avujve të ujit	5/20 (tabela e vlerave)

RÖFIX Renostar®

Rinovues dhe masë ngjithëse universale

Numri i artikullit	10189
Hapja e difuzionit të avullit	Përshkueshmëri e lartë
Forca në lidhje	$\geq 0,32 \text{ N/mm}^2$
Përcjellshmëria termike	rreth. $0,45 \text{ W/mK}$ për $P=50\%$ EN 1745:2002 (Vlera e tabelës) rreth. $0,49 \text{ W/mK}$ für $P=90\%$ EN 1745:2002 (Vlera e tabelës)
Moduli-E	rreth. 3500 N/mm^2
Koha e tharjes	rreth. 10 d
Grup Ilaçi	GP EN 998-1 CS II EN 998-1 Përmbajtja e VOC sipas Direktivës së BE-së 2004/42 (Direktiva e Dekopajit) EN 998-1
Trashësia e shtresës	1-10 mm
Kapaciteti termik	rreth. 1 kJ/kg K
Dëndësia në gjëndje të papërpunuar	rreth. 1300 kg/m^3
Temperatura e nënshtresës	5-25 °C
Këshilla për paketimin	Në thasë letre me mbrojtje kundër lagështisë.

Baza e materialit

- Lidhës dispersiv
- Fibra
- Rërë mermeri e imët me cilësi të lartë
- Gëlqere e pashuar
- Përbërës organik < 5%
- Çimento e bardhë (pa kromate)
- Aditivë për përmirësimin e vetive të përpunimit

Kushtet e punimit

Gjatë fazës së përpunimit dhe tharjes, ambjenti përreth sikurse dhe temperatura e bazamentit nuk duhet të bjerë nën $+5 \text{ °C}$ dhe të ngrihet mbi $+30 \text{ °C}$.
Gjatë kohës së aplikimit dhe forcimit të materialit, mbrojeni minimumi për 7 ditë nga ngricat.

Bazamenti

Sipërfaqet duhet të jenë të pastra, të fortë, pa lagështi të përhershme, pa pluhur, të qëndrueshme dhe të pa myke, vajra, graso, dhe të tjerë faktorë ndikues. Testimi i

bazamentit duhet të vijojë sipas ÖNORM B3346 ose DIN 18350 ose SIA V242. Pjesë suvaje të dëmtuara eliminohen. Pjesë të liruara ose të shkëputura në ndërtesa të vjetra të mbrojtura nga shteti, pastrohen vetëm duke marrë një miratim nga zyra përkatëse. Nëse këto pjesë nuk do të pastrohen ose zëvendësohen, atëherë duhet të ngjitsin përsëri në mënyrë profesionale.

Bazamenti-Trajtimi paraprak

Para rinovimit të suvasë së vjetër duhet të bëhet testimi i bazamentit për aftësinë mbajtëse me anë të "provës së shkuljes". Për këtë bëhet prova në 2 vënde mbi fasadë nga 1 m^2 ku bëhet aplikimi i Ilaçit me rrjetën përforcuese RÖFIX të futur në të. Pas tharjes (të paktën 7 ditë) bëhet testimi i fasadës dhe gjykohet sipas udhëzuesëve të RÖFIX. Suvatë apo shtresat e bojës pa aftësi mbajtëse duhet të eliminohen. Mbi sipërfaqe betoni te pastra dhe te thata nuk është e nevojshme lyerja me lende lidhëse (ngjitese).. Në bazamentet organike pastrimi duhet të kryhet me anë të hedhjes së ujit dhe jo me anë të pastresit me presion të lartë. Pas pastrimit lëreni bazamentin të thatet mjaftueshëm (rreth 10 ditë në kushte të mira atmosferike). Nëse bazamentet organike pastrohen me ujë me presion të lartë, koha e tharjes në këto rast zgjatet. Nënshtresat më pak të

RÖFIX Renostar®

Rinovues dhe masë ngjithëse universale

forta ose lëmuere mund të rifreskohen ose forcohen me astar të thellë silikat RÖFIX PP 201 SILICA LF.

Përgatitja

Në rast punimi me dorë përzieni një thes në makinerinë përzjerese me sasinë e nevojëshme të ujit, në mënyrë që të formohet një masë e njëtrajtëshme. Pas përzjerjes lëreni 10 min. në qetësi dhe pastaj përziheni përsëri. Nëse materiali është fortësuar nuk përzihet më.

Këshilla për përpunimin

Llaçin e freskët punojeni brenda 2 orëve. Gjatë tharjes duhet të përdorni mjete për ngrohjen- që të krijohen kushte më të mira për tharjen dhe fortësimin (psh. me ventilues). Ngrohja e drejtpërdrejtë e suvasë nuk është e lejuar. Materialin i hapur më parë nuk duhet përdorur, gjithashtu mos e përzieni me materialin e ri.

Përpunimi

Masa shpatulluese përhapet me shpatull ose mistri inoksi me dhëmbëza. Aplilimi mund të kryhet me një ose 2 shtresa. Shtrimi vijon me një ose dy shtresa. Trashësia optimale e stukos duhet min. 4mm.

Në rastin e përdorimit si shtresë armuese duhet të përdorni patjetër rrjetën armuese RÖFIX P50. Rrjeta përforcuese duhet të vendoset afër sipërfaqes por të jetë plotësisht e mbuluar.

Në aplikimin me makineri sprucojeni me pompën e suvasë. Më pas hiqni me mastar pjesët e tepërta. Nuk është i përshtatshëm për ngjitjen në sipërfaqe të mëdha të pllakave qeramike ose pllakave të gurëve natyrore. Shtrimi në sipërfaqe të vogla i pllakave në zona me rrjedhje ose lagje të pjesshme (si psh: kuzhina gatimi në ambiente shtëpie, tualete) është i mundur vetëm mbas një kohe tharje të mjaftueshme (4 javë). Në zona me lagështirë (si psh: sektore me rrjedhshmëri uji të vazhdueshme) nuk sugjerohen suvatë e gëlqeres. Në rastet e përdorimit si fino për fasadat, është e nevojshme lyerja me një bojë RÖFIX me bazë gëlqere, silikati ose silikoni. Me bojrat me silikat ose me silikon, lyerja e murit mund të behet pas minimumi 10 ditësh. Për një rregullim të mirë të klimës së shtëpisë ju rekomandojmë bojrat me difuzion avujsh dhe dioksid karboni si RÖFIX PE SESCO bojë me bazë gëlqere, RÖFIX

PI 233 ÖKOSIL ose PI 262 ÖKOSIL PLUS.

Magazinimi

Magazinojeni në vende të thata mundësisht mbi paleta druri. Koha e magazinimit min. 12 muaj.

Certifikatë



Udhëzime teknike dhe ligjore

Gjatë aplikimit të produkteve tona, respektoni të dhënat në skedat teknike, të cilat janë në përputhje me standardet e përgjithshme dhe specifike të vendit, si dhe të merren parasysh rekomandimet e shoqatës kombëtare të specialistëve.

Këshilla të përgjithshme

Kjo skedë teknike anullon dhe zëvendëson të gjitha versionet e mëparshme. Të dhënat e këtyre udhëzuesve teknike përkrijnë me njohuritë dhe përvojën tonë praktike të deritanishme. Ky informacion dhe të dhënat janë përpiluar me kujdes dhe me ndërgjegje të plotë, por pa mbajtur përgjegjësi për vendime ose veprime plotësuese që mund të marrë vetë konsumatori. Të dhënat në vetevete nuk provojnë asnjë lidhje ligjore ose detyrime të tjera anësore, dhe normalisht nuk e ndalojnë konsumatorin të testojë produktin për ato qëllime për të cilat edhe është prodhuar. Produktet RÖFIX si dhe të gjitha materialet përbërëse, i nënshtrohen një kontrolli të vazhdueshëm, me anë të të cilit garantohej një cilësi e pandryshueshme. Stafin ynë është i gatshëm tju japë cdo ndihmë teknike në lidhje me përdorimin, përpunimin si dhe mund të ofrojë edhe trajnime praktike në lidhje me përdorimin e produkteve tona. Skedat tona teknike më të reja, me të dhënat aktuale, mund ti gjeni edhe në faqen tonë të internetit (www.roefix.com), ose mund të kërkohen edhe pranë filjaleve rajonale në vënd. Informacione më të detajuara për sigurinë mund ti lexoni tek skedat tona të sigurisë. Përpara aplikimit të produkteve, jeni të lutur ti lexoni me kujdes këto skeda.



RÖFIX Renostar®

Rinovues dhe masë ngjitëse universale

Të gjitha të dhënat teknike të dhëna në këtë fletë produkti janë përcaktuar në kushte laboratorike.